

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 06. datë 30 / 10/ 2025

Nr _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. _____ datë 31 / 10 2025
2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM TË RISHIKUAR
2026-2028 (FAZA II)”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e pushtetit vendor” si dhe në mbështetje të VKB nr 87, datë 12.12.2024 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të

shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësitë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve. Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët. Në mënyrë të përmblodhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhëdisavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektive të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË GJIROKASTËR 2026-2028

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Gjirokastrë gjatë periudhës 2026-2028, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmblendhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2026-2028. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas

kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Gjirokastrë për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Ne tabelen 2. Te relacionit paraqiten të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2026-2028

Ne tabelën 3, te Relacionit paraqiten shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2023 deri në 2028.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Ky projekt vendim impakton te gjitha shtresat dhe kategorite e komunitet te bashkise Gjirokaster si dhe zhvillimin ekonomik te krejt territorrit te kesaj bashkie.

A është objekt i konsultimit publik:

Po

Komisioni i Përhershëm i i **“Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”**

i mbledhur me datën 30 / 10 / 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. ____ datë ____ / ____ 2025,
relacionit e dokumentat shoqërues në me propozimin

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM TË RISHIKUAR
2026-2028 (FAZA II)”** paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- ☒ a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- ☒ b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
 - ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“


(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

Datë 30 /10 2025